Dokument Përmbledhës i Projektit

Emri i Projekti:	Lidhja e Rrugëve Rajonale dhe Lokale
Vendi:	Shqipëri
ID projektit:	50123
Sektori Biznesit:	Transport
Shtetëror/Privat:	Sektori Shtetëror
Dita e Parashikuar e Bordit:	11 Dhjetor 2019
Statusi:	Ka marrë miratimin përfundimtar, në pritje të miratimit nga Bordi.
Data e publikimit te PSD:	13 Qershor 2018
Data e përditësimit të PSD:	19 Nëntor 2019

Përshkrimi i Projektit:

Dhënia e një kredie sovrane për Republikën e Shqipërisë në dobi të Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) për të financuar rehabilitimin e seksioneve kryesore rrugore rajonale dhe lokale në Shqipëri. Projekti është pjesë e një programi më të madh investimesh për rehabilitimin e rrjetit rrugor rajonal dhe lokal të Shqipërisë, i cili financohet paralelisht nga një kredi e Bankës Botërore.

Objektivat e Projektit:

- Të mbështesë zhvillimin ekonomik të Shqipërisë dhe të kontribuojë në integrimin e saj të brendshëm duke përmirësuar rrjetin e rrugëve rajonale dhe lokale. Projekti do të përmirësojë cilësinë e shërbimit rrugor dhe sigurisë rrugore dhe do të reduktojë shpenzimet operative të automjeteve dhe kohën e udhëtimit. Përmes përmirësimit të lidhjeve të transportit rajonal, Projekti do të ofrojë akses më të sigurt në qendrat ekonomike dhe do të sjellë përfitime për përdoruesit e rrugëve si dhe përfitime për sektorët e bujqësisë dhe turizmit.

- Nëpërmjet përfshirjes së rekomandimeve për rritjen e sigurisë rrugore dhe të masave për rritjen e qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimaterike, Projekti do të mbështesë fuqizimin e menaxhimit të sigurisë rrugore dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimaterike të cilat janë të një rëndësie të veçantë në Shqipëri për shkak të vendndodhjes së vështirë gjeografike të pjesës më të madhe të rrjetit rrugor.

Impakti në tranzicion:

- Projekti do të mbështesë integrimin e brendshëm të rajoneve të Shqipërisë duke përmirësuar lidhjen midis rajoneve të saj të cilat janë aktualisht të integruara në mënyrë joadekuate. Projekti do të përmirësojë infrastrukturën dhe shërbimet rrugore ndërmjet destinacioneve të rëndësishme turistike pëgjatë bregdetit shqiptar duke lehtësuar lëvizjen e mallrave dhe njerëzve dhe duke zvogëluar kostot e transportit.

- Projekti do të promovojë praktika prokurimi gjithëpërfshirëse për të ofurar mundësi trajnimi në punë për të rinjtë gjatë fazës së ndërtimit.

Informacion mbi Klientin:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Huamarrësi është Republika e Shqipërisë e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë. Klienti është FSHZH i cili është përgjegjës për zhvillimin e rrjetit rrugor lokal dhe rajonal.

Përmbledhje e Financimit të BERZH:

Hua sovrane deri në USD 50 milion. Huaja e Bankës do të ndahet në dy transhe:

- Transhi 1 në shumën deri USD 40 milion për financimin e rehabilitimit dhe përmirësimit të një seksioni rruge mes Vlorës dhe Orikumit, me gjatësi prej afërsisht 10.6 km ("Seksioni 1"); dhe një seksioni rruge mes Shengjinit dhe Baks-Rjollit, me gjatësi prej afërsisht 13 km ("Seksioni 2");

- Transhi 2 në shumën deri USD 10 million për financimin e përmirësimit dhe shtrimit të një seksioni rruge ndërmjet Zgoshtit dhe Urës së Cerenecit, me gjatësi prej afërsisht 47.1 km ("Seksioni 3").

Transhi 2, i cili do të angazhohet/vihet në dispozicion pas kryerjes me rezultate të kënaqshme nga ana e Bankës të të gjitha shqyrtimeve të nevojshme përfshirë dhe ato mjedisore e sociale për sekSionet përkatese të rrugëve. Para angazhimit të Transhit 2 do të kërkohet miratimi i Bordit të Bankës.

Kostoja totale e projekti:

USD 61,580,000.00

Kostoja totale e Projektit është parashikuar përafërsisht USD 61.6 milion.

Përmbledhja mjedisore dhe sociale:

Kategorizuar B IESE (2014). Projekti pritet të përmirësojë cilësinë e rrugëve, sigurinë, aksesin dhe të adresojë masa për rritjen e qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike pasi rrugët në Shqipëri shpesh janë subjekt i ndikimeve nga përmbytjet dhe rrëshqitjet e tokës. Ndikimet mjedisore dhe sociale (M&S) që lidhen me Projektin pritet të jenë identifikuar dhe të menaxhohen nëpërmjet zbatimit të një plani veprimi mjedisor dhe social (PVMS). Seksionet e rrugëve që do të rehabilitohen apo ndërtohen në kuadër të programit të investimeve u përzgjodhën bazuar në plane strategjike dhe në analiza kriteresh të shumëfishta me fokus prioritetet për turizmin dhe bujqësinë.

Përmirësimi dhe shtrimi i Seksionit 3 që do të financohet nga Projekti do të kalojë në një proces të veçantë shqyrtimi M&S dhe do të jetë subjekt i një miratimi më vete nga Bordi.

Analiza Mjedisore dhe Sociale (AMS) e kryer nga ana e Departamentit Mjedisor dhe të Qendrueshmërisë përfshiu një shqyrtim të planeve të investimit të Seksionit 1 dhe Seksionit 2, sistemeve të menaxhimit të FSHZH, dokumentacionit mbështetës dhe një vizite në vend. AMS konstatoi se FSHZH ka krijuar një Kuadër të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (KMMS) i cili parashikon

një vlerësim M&S, Plan të Menaxhimit M&S (PMMS), konsultim me palët e interesit dhe publikim të informacionit për çdo projekt. Gjithashtu, sipas rastit parashikon zhvillimin e një Kuadri të Politikave të Strehimit dhe të një Plani Veprimi te Strehimt (PVS). Ndërkohë që Kuadrat gjithëpërfshirëse janë strukturuar me kalimin e kohës për të qenë në përputhje me shumicën e kërkesave të Institucioneve Financiare Ndërkombëtare, AMS konstatoi se disa fusha kishin nevojë për përmirësim të mëtejshëm për tu siguruar që projektet strukturohen për të qenë në përputhje të plotë me Kërkesat e Performancës (KP) të BERZH, sidomos për sa i përket punës, menaxhimit të kontraktorëve, menaxhimit të trafikut, zhvendosjes, dhe angazhimit me palët e interesit.

Seksioni 1 dhe Seksioni 2 janë në një fazë të hershme zhvillimi kështu që do të duhet të plotësojnë kërkesat rregullatore kombëtare dhe të marrin lejet e nevojshme. Përgatitja e Projektit në përputhje me KMMS të përditësuar parashikohet të plotësojë KP të BERZH megjithatë, dokumentacioni i projektit do t'i nënshtrohet një shqyrtimi të pavarur për të konfirmuar këtë gjë.

Projekti ndodhet brenda një zone me një vlerë të lartë biodiversiteti pasi ai do të përshkojë Peisazhin e Mbrojtur të Lumit të Bunës (Kategoria 5 e IUCN – Bashkimi Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës; Park Kombëtar), Ramsar, Zonë e Rëndësishme për Shpendët, Zonë e Rëndësishme Bimore dhe Zonë Kandidate Smerald për 10.82 km. Zona e Zhvillimit të Projektit (ZZHP, e perkufizuar si zona e ndikimit të Projektit, gjerësia e punimeve, dhe zonat e lidhura të punimeve) është identifikuar si zonë që ofron vendbanim për një numër speciesh endemike, të rralla dhe në kërcënim në shkallë kombëtare dhe globale. Me një përqasje të kujdesshme, një hulumtim i shpejtë i habitatit në gjendje kritike dhe karakteristikave prioritare të biodiversitetit konfirmoi praninë e disa ndjeshmërive të rëndësishme për Projektin të cilat kanë një vlerë të lartë biodiversiteti, konkretisht specie që kualifikohen si kritike ne lidhje me habitatet dhe habitate, konkretisht laguna bregdetare dhe Lumi i Bunës, që lidhin zona ujore dhe habitate moçalore të Liqenit të Shkodrës dhe kompleksit Ramsar të Lumit të Bunës dhe Peisazhit të Mbrojtur të Lumit të Bunës. Ne Muajin Gusht 2019 u ndërmorr një Vlerësim i Ndikimit në Biodiversitet për Projektin për të plotësuar Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) si edhe një Vlerësim i Rregulloreve të Habitateve për të përcaktuar nëse Projekti mund të kishte efekte të ndjeshme të mundshme mbi Liqenin e Shkodrës dhe kompleksin Ramsar të Lumit të Bunës si dhe të zonës kandidate Smerald. Megjithëse gjatë fazës së shqyrtimit u identifikuan efekte të ndjeshme të mundshme sipas tetë kritereve të vlerësimit, pas zbutjes së tyre u përcaktua që asnjëri prej këtyre ndikimeve nuk do të prekte integritetin e rezervës. Aplikimi i kujdesshëm i masava të praktikave më të mira për minimizimin dhe menaxhimin e riskut të ndikimeve të mundshme që lidhen me Projektin e që lindin nga humbja ose degradimi i habitatit, zhurmat dhe dridhjet, përplasjet aksidentale të automjeteve me faunen, ndotja nga drita artificiale, ndotësit e ajrit dhe ujit, barrierave ndaj lëvizjes, ndryshimeve në hidrologji dhe cilësinë e ujit, parashikohet të minimizojnë riskun ndaj habitateve prioritare, specieve dhe Peisazhit të Mbrojtur të Lumit Buna. Në vijim të zbutjes, nuk u identifikuan ndikime ndaj specieve të kualifikuara si habitat, lagunës bregdetare dhe Lumit Buna, trupave ujorë ndërlidhës, habitateve moçalore të kompleksit të Liqenit të Shkodrës dhe Ramsarit të Lumit Buna. Megjithatë Projekti do të rezultojë në humbjen e përhershme të rreth 13 ha habitati tokësor brenda zonës së ndikimit të Projektit prej të cilave një habitat prej rreth 11 ha do të pastrohet nga Peisazhi i Mbrojtur i Lumit Buna (një karakteristikë kritike e kualifikuar si habitat). Për të siguruar jo një humbje por një përfitim neto të biodiversitetit, do të hartohet dhe zbatohet një strategji kompensimi e biodiversitetit. Një prioritet kyç i Projektit është mbështetja e vazhdueshme për ruajtjen e Peisazhit të Mbrojtur të Lumit Buna dhe të kompleksit të Ramsarit të Liqenit të Shkodrës dhe Lumit Buna për këtë arsye, do të zbatohet një Projekt i Qëndrueshëm Eko-Turizmi për

të zhvilluar një program të qëndrueshëm eko-turizmi për të zbutur ndikimet indirekte në biodiversitet që lidhen me aksesin e lehtësuar nga Projekti dhe hyrjen e turistëve. Një Plan i Menaxhimit të Biodiversitetit është përgatitur nga konsulentë të pavarur për projektin dhe detajon iniciativat a menaxhimit të biodiversitetit, angazhimet dhe detyrimet për të ruajtur dhe promovuar speciet dhe habitatet prioritare që lidhen me Projektin, ne përputhje me kërkesat e KP6. Ky plan përfshin zhvillimin dhe zbatimin e një Plani Rikthimi e Rregullimi të Peisazhit për të rikthyer habitatet në gjendjen e mëparshme dhe zbatimin e një Programi të Monitorimit dhe Vlerësimit të Biodiversitetit për të informuar menaxhimin përshtatës.

Ndërkohë që Projekti ka të bëjë kryesisht me rehabilitim të rrugëve ekzistuese, ai do të përfshijë edhe ndërtimin e dy seksioneve të reja rrugore përkatësisht prej 1.7 km dhe 2.19 km për të mundësuar zhvillimin e zonave për këmbësorë dhe rekreative përgjatë bregut të detit. Ndikimet përkatëse të mundshme të këtyre gjurmëve apo gjurmëve të tjera mbi tokën dhe gjallesat do të adresohen nëpërmjet zhvillimit dhe zbatimit të RSP/PRGJ të përshtatshme për Projektin. Zhvendosja fizike parashikohet të kufizohet në dy shtëpi në njërën prej gjurmëve të rrugëve por kjo do të konfirmohet gjatë projektit të detajuar teknik.

Duke qenë se disa seksione rrugësh të Projektit ndodhen në zona të ngarkuara turistike, do të kërkohet kujdes i veçantë për menaxhimin e trafikut dhe sigurinë rrugore gjatë punimeve përfshirë dhe rregullimet për menaxhimin e riskut rrugor profesional. Gjithashtu, do të ndërmerret një auditim i sigurisë rrugore për çdo seksion.

FSHZH ka emëruar një specialist të Angazhimit me Qytetarët për të koordinuar angazhimin me palët e interesit, median sociale dhe mekanizmin e ankesave dhe për të siguruar publikimin e informacioneve mbi Projektin dhe që konsultimet kryhen ne përputhje me KP10 të BERZH. Gjithashtu, do të ndërmerret edhe një Program i Qëndrueshëm dhe Eko-Turizmi i cili do të pëfshijë aktivitete të angazhimit me palët lokale të interesit.

Është përgatitur një Plan Veprimi Mjedisor dhe Social (PVMS) i cili përfshin kërkesa si: përditësim të KMMS dhe Kuadrin e Zhvendosjes dhe Politikave të Projektit për të qenë në përputhje të plotë me KP-të e Bankës; zbatimin e përmirësimeve të kërkesave të menaxhimit të kontraktorëve dhe zgjerimin e hapësirës së PMMS për t'i përputhur me KP të BERZH; zbatimin e Planit të Menaxhimit të Biodiversitetit; zhvillimin dhe zbatimin e planeve te trafikut dhe sigurisë rrugore duke përfshirë rreziqet rrugore profesionale dhe të komunitetit; zbatimin e mekanizmave të ankesave; procedurave të gjetjes rastësore; dhe zbatimin e planit të angazhimit me palët e interesit.

Klienti do të paraqesë Raporte Vjetore M&S mbi përputhshmërinë e Projektit me KP dhe zbatimin e PVMS.

- Vlerësimi i Ndikimit në Biodiversitet
- Plani i Menaxhimit të Biodiversitetit
- Vlerësimi i Rregulloreve të Habitateve
- Përmbledhje jo-Teknike: Shqip | Anglisht
- Vlerësimi Shtese i të Dhënave Bazë të Biodiversitetit

Bashkëpunimi Teknik:

Si pjesë e Projektit janë parashikuar edhe këto programe të Bashkëpunimit Teknik:

1. Përgatitja e një programi për turizëm ekologjik dhe të qëndrueshëm;

2. Mbikëqyrja e punimeve;

3. Mbështetje për zbatimin e Projektit.

Informacion Kontakti i Klientit:

Ermir Omari

eomari@albaniandf.org

+355 4 2235 597

www.albaniandf.org

Rr. Sami Frasheri, Nr. 10, Tiranë, Shqipëri

Mundësi biznesi:

Për mundësi biznesi ose prokurimi, kontaktoni klientin.

Për projekte të sektorit shtetëror vizitoni EBRD Procurement: Tel: +44 20 7338 6794

Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Pyetje mbi projekte të BERZH të cilat nuk lidhen me prokurimin:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: projectenquiries@ebrd.com

Politika e Informimit të Publikut (PIP):

PIP përcakton mënyrën se si BERZH bën publike informacionet dhe konsultohet me palët e interesit me qëllim promovimin e ndërgjegjësimit mbi dhe të të kuptuarit e strategjive, politikave dhe operacioneve të saj. Lutemi vizitoni faqen e Politikës së Informimit Publik këtu më poshtë për tu njohur me mënyrën se si mund të kërkoni një Raport të Bordit për Sektorin Publik.

Teksti i PIP

Mekanizmi i Ankesave mbi Projektet

Mekanizmi i Ankesave mbi Projektet (MAP) është mekanizmi i llogaridhënies së BERZH. Ai ofron një mundësi për vlerësim të pavarur të ankesave të paraqitura nga individë dhe organizata lidhur me projekte të financuara nga BERZH të cilët mendohet se kanë shkaktuar ose ka gjasa të shkaktojnë dëme mejdisore dhe/ose sociale.

Lutemi vizitoni faqen e Mekanizmit të Ankesave mbi Projektet për tu informuar mbi si mund të paraqitet një ankesë. Punonjësi i MAP (pcm@ebrd.com) është në dispozicion për t'ju përgjigjur çdo pyetjeje që mund të keni në lidhje me paraqitjen e një ankese si dhe kriteret për regjistrimin e pranueshmërinë, në përputhje me Rregullat e Procedurat e MAP.